



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE E KONTROLLIT TË TERRITORIT, MJEDISIT
DHE PRONËS
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE PUBLIKE

Nr. 3032 Prot.

Gramsh, më 20 / 07 / 2026

RELACION

PËR KALIMIN NË FOND BANESE TË OBJEKTIT "ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE"
PASURIA NR. 7/97 ZONA KADASTRALE 1842, NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH,
PËR QËLLIME STREHIMI DHE PRIVATIZIMI.

Të nderuar Këshilltarë!

Baza ligjore.

Referuar VKM-së nr. 431 datë 11.07.2007, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit", sipas VKM-së "Ish Ndërmarrja e Shqopave", ka kaluar në pronësi të Bashkisë Gramsh dhe është certifikuar.

Në rastet kur organet e qeverisjes vendore marrin vendim për kalimin e pronësisë së këtyre objekteve, subjekteve private, të procedohet në përputhje me legjislacionin në fuqi mbështetur në Ligjin nr. 22, datë 03.05.2018, "Për Strehimin Social" si dhe për vlerësimin e pronës referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar "Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese."

Nisur nga fakti që ky objekt është amortizuar si dhe nga kërkesat e njëpasnjëshme të qytetarëve për privatizimin e tyre, kemi menduar që ta trajtojmë në Këshillin e Bashkisë për kalimin në fond banese dhe privatizimin e saj sipas kontratave respektive të qytetarëve. Në zbatim të Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.2, paraqesim para Këshillit të Bashkisë Projekt-Vendimin përkatës duke ju sqaruar si më poshtë vijon :

Përshkrimi i situates së objektit:

Qytetarët të cilët banojnë në këtë objekt janë duke u pajisur me kontrata qiraje dhe duke qënë se objekti ka qënë i amortizuar, qytetarët i kanë kryer vetë investimet për ta përshtatur për strehim. Objekti ka vite që e ka humbur funksionin e tij dhe nuk shërben për asnjë funksion tjetër përveç strehimit.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" nga mungesa e fondeve buxhetore për mirmbajtje apo për ndërhyrje për rikonstruksion, kemi lejuar të kryhen punime të objekteve të dhëna me qira për ta përshtatur sipas kontratës që ka lidhur me Bashkinë Gramsh për banim.

Për sa më sipër, me pëlqimin e qiradhënësit sipas dispozitave të Kodit Civil neni 801 e vijues parashikon lejimin për riparime, përmiresimin e objektit të dhënë me qira të parashikuara edhe në kontratë për ta bërë atë të përshtatshme për banim.

Këshilli i Bashkisë ka autoritetin të vendosë përcaktimin destinacionin e përdorimit të këtyre objekteve, për t'i kthyer ato në fond banese dhe me qëllim privatizimin e tyre, referuar Vendimeve të Këshillit të Ministrave të sipërcituara.

“Ish Ndërmarrja e Shqopave” është ndërtuar rreth viteve 60’, dhe që prej asaj kohe mungesa e investimeve me ndryshimet e sistemit të viteve 90 ka bërë që të amotizohet dhe ta humbasi funksionin e saj. Më pas ky objekt është kthyer në identitet dhe është riparuar nga vetë qytetarët që ta bëjnë të përshtatshëm për qëllim banimi.

Nisur nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) të ushtruar në Bashkinë Gramsh për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2024, me nr. 405/17 Prot. datë 21.10.2025 regjistruar me tonën nr. 4730 Prot. datë 24.10.2025 si dhe rekomandimet e lëna, para miratimit në Këshillin e Bashkisë, u ngrit komisioni me Urdhër të Kryetarit, nr. 135, datë 07.04.2026, i cili ka bërë matjet dhe verifikimet në terren për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor për tjetërsimin e pronës.

Lista emërore e qytetareve që banojnë në këtë objekt, sipas verifikimeve në teren dhe kërkesave të tyre ndër vite janë si më poshtë:

OBJEKTI ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE
PASURIA NR 7/97 ME SIPËRFAQE TOTALE S-376 M², NDËRTESE-339.6 M²
EMËRTIMI: ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE

ME POSEDUES:

- 1.Valentina Dervishi me sip. 29.8m
- 2.Burbuqe Latifi me sip.44.6m²
- 3.Besim Taragjini me sip.95m²
- 4.Muke Tafa me sip. 81.7m²
- 5.Nefail Tafa me sip. 82.2m²
- 6.Xhile Veliu me sip. 42.6m²

Sa më sipër i propozojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë Relacionin dhe P/Vendimin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe e Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Sektori i Administrimit të Pronave Publike, Bashkia Gramsh .

Bashkëlidhur një kopje të dokumentacionit .

- 1.Çertifikata e regjistrimit të pronësisë.
- 2.Kartela e Pasurisë së Paluajtshme.
- 3.Fragmenti i Hartës Kadastrale.
- 4.Planimetritë dhe Planvendosjet për secilin nga poseduesit

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj !

KRYETARI I BASHKISË
Besion AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3032/ prot

Gramsh, më 20/07/2026

P/V E N D I M

Nr. _____ datë, ____/____/ 2026

P Ë R

KALIMIN NË FOND BANESE TË OBJEKTIT "ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE"
PASURIA NR. 7/97, NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, PËR QËLLIME STREHIMI
DHE PRIVATIZIMI.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe e Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Sektori i Administrimit të Pronave Publike.

Bazuar në Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.12.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit", dhe sipas VKM-së "Ish Ndërmarrja e Shqopave", ka kaluar në pronësi të Bashkisë Gramsh dhe është certifikuar.

Mbështetur në Ligjin nr. 22, datë 03.05.2018, "Për Strehimin Social" si dhe për vlerësimin e pronës referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 179, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, që kanë qënë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", të ndryshuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.2, me propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

1. Kthimin në fond banese të objektit "Ish Ndërmarrja e Shqopave", në pronësi të bashkisë Gramsh, ndarjen dhe certifikimin e çdo njësie banimi sipas listës së miratuar të banoreve që banojnë në to duke specifikuar dhe sipërfaqet respektive të tyre.

2. Nisjen e procedurave të privatizimit të familjareve që banojnë si më poshtë:

LISTA EMERORE E OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA

OBJEKTI NR.1

**PASURIA NR 7/97 ME SIPËRFAQE TOTALE S-376 M² DHE SIP. NDËRTESE S-339.6 M².
EMËRTIMI: ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE.**

ME POSEDUES:

- 1.Valentina Dervishi me sip. 29.8m
- 2.Burbuqe Latifi me sip.44.6m²

- 3.Besim Taragjini me sip.95m²
- 4.Muke Tafa me sip. 81.7m²
- 5.Nefail Tafa me sip. 82.2m²
- 6.Xhile Veliu me sip. 42.6m²

3. Vlersimi i pronës të llogaritet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar.

4. Në përfundim të procedurës të lidhen kontratat e shitjes para noterit midis qytetarëve të mësipërm në cilësinë e blerësit dhe Bashkisë Gramsh në cilësinë e shitësit i përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij.

5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Privatizimit të banesave pronë e bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI